

Të nderuar z. deputetë,

Më lejoni t'ju falenderoj për këtë nismë të rëndësishme për t'u dëgjuar mbi vlerësimet e bëra në Progres Raportin e BE – 2014 dhe për të evidentuar nismat për zbatimin e rekomandimeve që prezantohen në raport dhe identifikimin e nevojave që kërkojnë mbështetjen tuaj institucionale.

Zyra e Komisionerit ka një aktivitet gjashtë vjeçar e orientuar në zhvillimin e komponentit ligjor, të ndërgjegjësimit me ligjin përkatës e deri në hetim administrativ, për të cilat është raportuar në Kuvend nga njëri vit në tjetrin dhe është punuar për përmbushjen e kërkesave të rezolutave pas raportimeve.

Në Progres Raport, vlerësohet puna e Zyrës së Komisionerit duke evidentuar përmirësimin e bashkëpunimit të Komisionerit me institucione si Prokuroria, ILDKPKI, AKEP apo edhe vendosja e numrit të telefonit falas në faqen zyrtare të institucionit.

Ndërkohe, konstatohen detyra të cilat direkt apo indirekt përkthehen në rekomandime që kërkojnë nisma e mbështetje në realizim.

Në raport vlerësohet miratimi i Ligjit për të Drejtën e Informimit, zbatimi i të cilit është përgjegjësi e plotë e Komisionerit tashmë për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Progres Raporti shprehet *“Në shtator është miratuar ligji i ri për të drejtën e informimit, i cili i jep përgjegjësinë Komisionerit të trajtojë ankesa të caktuara. Kapacitetet e Komisionerit duhet të forcohen siç duhet”*, duke e fokusuar këtë nevojë jo të ndarë nga fusha tjetër që zyra mbulon, mbrojtjen e të dhënave personale. Ky rekomandim është në një linjë edhe me atë çfarë është parashikuar në ligjin për të drejtën e informimit se, trajtimi i praktikave nga zyra e Komisionerit për të drejtën e informimit duhet të bëhet nga struktura e posaçme për zbatimin e kësaj të drejte.

Për këtë, është përgatitur struktura e re me vëmendje të veçantë konsolidimin e autoritetit në të dy shtyllat përkatëse duke parashikuar krijimin e një strukture të re për të drejtën e informimit dhe forcuar strukturën aktuale për mbrojtjen e të dhënave personale.

Rritja dhe përforcimi institucional, mbështetja financiare e logjistike, do të ketë tregues në rritje në monitorimin e zbatimit të ligjeve respektive, në hetimet administrative, në disiplinimin e kontrolluesve për të përmbushur rekomandimet, në vendimarrjet me sanksione për të gjithë rastet e konstatuara në shkelje, në ndjekjen e të gjithë procedurave administrative e gjyqësore, etj.

Kjo është një ndër nismat më të rëndësishme e cila kërkon pa dyshim mbështetjen e Kuvendit të Shqipërisë për të realizuar miratimin e saj. Kjo arritje në një kohë sa më të shpejtë mundëson edhe përmbushjen e shumë detyrimeve që autoriteti ynë ka në zbatim të ligjit për të drejtën e informimit, madje realizimi i tyre na kushtëzon edhe në afate konkrete tepër të shkurtra të parashikuara në ligj, për shkak edhe se hyrja në fuqi e ligjit, çka nënkupton zbatimin e tij, nis që prej ditëve të para të Nëntorit.

Një strukturë me kapacitet të forcuar do të shërbejë për të prezantuar në shërbim, cilësi e afate, Zyrën në raport me partnerët ndërkombëtarë, do të sjellë të tjera rezultate edhe në ndërtimin e marrëdhënieve me to, duke krijuar dhe forcuar lidhje edhe me organizma të tjera si EUROJUST dhe EUROPOL me synim shkëmbim të praktikave më të mira, bashkëpunim në drejtime të caktuara, etj.

Progres Raporti vazhdon të evidentojë problematikën e shfaqur sa i përket dërgimit të projekt akteve ligjore dhe nënligjore nga institucionet porpozuese, për mendim pranë Komisionerit, përpara miratimit të tyre në KM. Është e kuptueshme që përmbushja e këtij detyrimi i takon institucioneve por, roli ynë bashkëpunues synon të jetë aktiv.

Në Progres Raport shprehimisht citohet:

“Komisioneri ende nuk rezulton ndër institucionet që duhet të konsultohen për nisma legislative të propozuara”.

Në këtë drejtim u iniciua dhe me kontributin e Sekretarit të Përgjithshëm të KM u realizua një takim me Sekretarët e Përgjithshëm të Ministrive.

Qëllimi ishte të evidentonim rëndësinë që ka dërgimi i p/akteve për mendim pranë Zyrës së Komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale por njëkohësisht nga autoriteti ynë ishte përgatitur edhe një udhërrëfyes me të cilën ata u njohën dhe u pajisën.

Kjo nismë e re, mund të themi rezultoi e suksesshme pasi, është vërejtur ndërgjegjësim në këtë drejtim dhe se ka nisur të ndjehet rritja e numrit të p/akteve të dërguara për mendim pranë KMDP-së.

Gjithashtu, në Progres Raport vihet theksi edhe në *“Zhvillimin e sistemeve IT në administratën publike i cili duhet të arrihet në respektim të dispozitave të mbrojtjes së të dhënave”*.

Në fakt, në këtë drejtim janë kryer monitorime të faqeve zyrtare të institucioneve për të cilat janë dhënë rekomandime përkatëse kryesisht mbi publikimin në to, të politikave të privatësisë.

Një nismë e re synohet të ndërmerret së shpejti. Arritja dhe finalizimi i saj është bashkëpunimi në nivel të ri me AKSHI-n si autoriteti që administron infrastrukturën teknologjike dhe të komunikimit për institucionet publike.

Vëmendje e veçantë në këtë rast do ti kushtohet ndërtimit të një sistemi online, nëpërmjet të cilit Zyra e Komisionerit do të monitorojë njëkohësisht online zbatueshmërinë e të dy ligjeve për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

Për këtë zhvillim të ri kërkohet forcimi i kapaciteteve institucionale nëpërmjet investimeve për zhvillimin e infrastrukturës informatike, për krijimin e një ndërveprimi me të gjithë institucionet publike.

Problematik mbetet roli dhe raporti me median. Në Progres Raport citohet: *“Media e shkel shpesh të drejtën e mbrojtjes së të dhënave personale”*.

Deri më tani, Komisioneri nëpërmjet konstatimeve të ndryshme nga leximi i shtypit të shkruar por edhe nga kërkesat apo ankesat e paraqitura, ka dërguar rekomandime mediave të shkruara dhe kryesisht ka kërkuar prej tyre, **mos publikimin e të dhënave personale të të miturve të përfshirë në ngjarje dhune, fshirjen e të dhënave personale të viktimave të mitur të dhunës nga baza e të dhënave elektronike, respektimin e etikës së gazetarit në ushtrimin e profesionit të tij dhe veçanërisht në raportimin e fakteve të kronikës që përfshijnë të mitur.**

Gjithashtu në këtë drejtim, Komisioneri ka organizuar edhe tryeza trajnimi me gazetarët dhe takime me përfaqësues të tyre. Por konstatohet që nuk kane qene te mjaftueshme.

Një nismë e re vlerësohet të merret në këtë drejtim. Vleresojme të fillohet nga nënshkrimi i një marrëveshje me AMA si dhe me forumet e gazetarëve. Kjo do të synojë shndërrimin e tyre në aleatë për të parandaluar shkelje të tilla nga njëra anë dhe nga ana tjetër për të përçuar mesazhe ndërgjegjësuese në publik apo edhe për të krijuar akses të vazhdueshëm në media. Por, në asnjë moment nuk do të përjashtohet mundësia e ndëshkimit për shkelje të konstatuara apo zbehët roli institucional pavarësisht bashkëpunimit.

Një tjetër evidentim, në Progres Raport megjithëse nuk është përgjegjësi e Komisionerit, mbetet zbatimi i udhëzimit mbi anonimizimin e të dhënave personale në vendimet gjyqësore të publikuara në portalet online të gjykatave. Edhe në këtë rast roli bashkëpunues me Ministrinë e Drejtësisë për arritjen e këtij qëllimi është bërë evident nëpërmjet pjesëmarrjes sonë në grupin e punës së ngritur nga Ministria e Drejtësisë në përmbushje të këtij qëllimi.

Pavarësisht citimit në Progres Raport se, “*numri i ankesave të dorëzuara pranë Komisionerit për Mbrojtjen e Të Dhënave Personale ka pësuar rritje të lehtë, nga 22 në vitin 2012, në 26 në vitin 2013; Shumica e rasteve kanë të bëjnë me përdorimin e të dhënave personale nga institucionet publike gjatë fushatës zgjedhore të vitit të kaluar*”, ndjejmë përgjegjësinë e asaj çfarë duhet bërë më mirë për të pasur një kurbë rritje të lartë pasi ky do të ishte treguesi më i mirë i njohjes së individëve me ligjin.

Megjithëse deri tani numri i ankesave për vitin 2014 ka arritur në 65, vlerësojmë se rritja dhe forcimi i kapaciteteve institucionale do të bëjë të mundur arritjen e ndërgjegjësimit në nivelin e kërkuar.

Por, që kjo të arrihet apo edhe që të përmbushim denjësisht ato çfarë evidentuam më sipër kërkojnë mbështetjen tuaj jo vetëm në miratimin e strukturës së re por edhe në ndryshimin e vendodhjes së ambienteve të punës.

Para disa muajsh Zyra e Komisionerit është transferuar në ambiente të tjera pune. Për shkak të vendndodhjes së tyre, por edhe të natyrës së punës që kanë institucionet publike apo bizneset private që ushtrojnë aktivitetin në të njëjtën godinë, ndodhemi në një situatë pamundësie të ofrimit lehtësisht të aksesit për publikun, komunikimit me median, pa përjashtuar këtu edhe përfaqësuesit ndërkombëtarë që vizitojnë zyrën e Komisionerit.

Gjithashtu, vendodhja aktuale nuk lejon as mundësinë e lidhjes dhe aksesit me rrjetin GovNet, për përfitimin e shërbimeve e-Gov.

Kjo problematikë u shfaq edhe nga ekspertët e Misionit të BE-së “Peer Mission Review” në raportin paraprak të tyre.

Besoj se me vlerësimet e mësipërme, kemi një panoramë realiste të situatës dhe të objektivave të rekomanduara nga Progres Raporti i BE.

Ju faleminderit.